



Prokurori i Shtetit
Državni Tužilac/ State Prosecutor
Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
Kancelarija Glavnog Državnog Tužioc
Office Of The Chief State Prosecutor



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Of Kosovo



Këshilli Prokurorial i Kosovës
Tužilački Savet Kosova
Kosovo Prosecutorial Council

UDHËZUES I PËRKOHSHEM
PËR MBROJTJE NGA COVID-19 NË SISTEMIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

Maj, 2020

Hyrja

Ky udhëzues është mbështetur në udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë, përmes së cilit jepen udhëzime në lidhje me parandalimin, luftimin dhe mbrojtjen ndaj virusit COVID 19, virus ky i cili ka përfshirë të gjitha vendet e botës.

Duke qenë se COVID-19 është një sëmundje respiratore, që nuk mund të parashikohet sa do të zgjasë dhe që mund të përcillet nga një person tek tjetri, masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së infeksionit do të bëhen të detyrueshme për një kohë të pacaktuar. Prandaj, Këshilli Prokurorial i Kosovës, i mbështetur në udhëzimet e institucioneve vendore të shëndetësisë për kontrollin dhe parandalimin e virusit, ka përgatitur udhëzues, që do të jenë në përditësim të vazhdueshëm, varësisht nga udhëzimet dhe vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Qëllimi

Udhëzimet kanë për qëllim të mbrojnë dhe parandalojnë përhapjen e virusit COVID-19 në vendin e punës në sistemin prokurorial të Kosovës.

1. Informata të përgjithshme mbi mundësin e përhapjes së COVID-19

1. Simptomat e COVID-19

Infeksioni me SARS-CoV-2, virusi që shkakton COVID-19, mund të shkaktoj sëmundje duke filluar nga forma e lehtë në të rëndë dhe në disa raste, mund të jetë fatale. Simptomat zakonisht përfshijnë ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje. Sëmundja mund të manifestohet me simptoma tjera si ato të infeksionit gastrointestinal. Po ashtu, personi mund të jetë asimptomatik por të jetë i infektuar me COVID-19. Sipas OBSH dhe CDC, simptomat e COVID-19 mund të shfaqen prej 2 ditë deri në 14 ditë pas ekspozimit.

2. Përhapja e COVID-19

Duke ju referuar udhëzuesit të Inspektoratit të Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, tek njerëzit infeksioni mund të përhapet nga personi në person, duke përfshirë:

- Kontakt i ngushtë i personave me njëri-tjetrin (më pak se 2 metra).
- Nëpërmjet spërklave kur një person i infektuar kollitet ose teshtin. Këto spërkla mund të futen në gojë ose hundë tek personat në afërsi dhe kontaminojnë sipërfaqet të cilat më pas mund të preken me duar dhe përmes duarve të futen në gojë ose hundë.

Është e mundur që një person të infektohet me COVID-19 duke prekur sipërfaqen ose objekt të kontaminuar me SARS-CoV-2 dhe më pas duke prekur gojën, hundën ose edhe sytë e tyre.

Njerëzit janë më *kontagjioz* kur kanë simptoma (d.m.th., kanë ethe, kollë dhe frymëmarrje të vështirësuar), por përhapja mund të jetë e mundshme edhe nga personat e infektuar por pa simptoma, megjithatë kjo nuk është rruga kryesore e përhapjes së virusit.

Kur dikush që është i infektuar COVID-19 kollitet ose me ekspirim lëshon spërklat dhe lëngjet e infektuara me virusin. Shumica e këtyre spërklave bien në sipërfaqet dhe objektet e afërta – të tilla si tavolina e punës, tryezat ose telefonat. Njerëzit mund të marrin COVID-19 duke prekur sipërfaqet ose objektet e ndotura – dhe më pas duke prekur sytë, hundën ose gojën. Nëse personat qëndrojnë në distancë më pak se dy metra në afërsi të personit tjetër që ka COVID-19 personat mund ta marrin COVID-19 duke i futur në organizëm atë përmes spërklave të hedhura jashtë gjatë kollitjes apo ekspirimit (nxjerrja jashtë e frymës gjatë frymëmarrjes). Me fjalë të tjera, COVID-19 përhapet në një mënyrë të ngjashme me gripin. Shumica e personave të infektuar me COVID-19 shfaqin simptoma të buta dhe ata shërohen. Sidoqoftë, disa vazhdojnë të shfaqin simptoma më të rënda dhe mund të kërkojnë kujdes spitalor. Rreziku i sëmundjes së rëndë rritet me moshën: njerëzit mbi 40 vjeç duket të jenë më të ndjeshëm se ata nën moshën 40 vjeç. Njerëzit me sistem imunitar të dobësuar dhe njerëzit me sëmundje të tjera kronike si diabeti, sëmundjet e zemrës dhe mushkërive janë gjithashtu më të ndjeshëm.

3. Zvogëlimi i përhapjes të virusit COVID 19 në mesin e të punësuarve

Me qëllim të zvogëlimit të përhapjes së virusit Covid 19 duhet të zbatohen këto masa¹:

- Të punësuarit e sëmurë duhet të qëndrojnë në shtëpi.
- Të punësuarit që kanë simptoma (p.sh., temperaturë, kollitje apo vështirësi në frymëmarrje), duhet të njoftojnë punëdhënësin e tyre dhe të qëndrojnë në shtëpi.
- Të punësuarit e sëmurë, duhet të ndjekin udhëzimet dhe rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (www.kosova.health) dhe të mjekëve të tyre familjarë.
- Të punësuarit nuk duhet të kthehen në punë deri sa të plotësohen kushtet/kriteret e ndërprerjes së izolimit shtëpiak, në konsultim me mjekun familjarë dhe institucionet gjegjëse shëndetësore;
- Të punësuarit që janë mirë me shëndet, por kanë anëtarë të sëmurë të familjes me COVID 19 në shtëpi, duhet gjithashtu të njoftojnë mbikëqyrësin e tyre dhe të ndjekin udhëzimet dhe rekomandimet e Ministrisë së shëndetësisë, Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (www.kosova.health) dhe të mjekëve të tyre familjarë.

¹ Mbështetur në udhëzuesin e përkohshëm të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik

- Nëse një i punësuar është konfirmuar të jetë i infektuar me COVID-19, duhet të informojnë të punësuarit tjerë për mundësinë e ekspozimit të tyre në COVID-19 në vendin e punës, por duhet të ruajnë konfidencialitetin sipas rregullave etike.
- Mbikëqyrësi duhet të udhëzojnë te punësuarin se si të vazhdojnë punën duke u bazuar në udhëzimet e këtij udhëzuesi dhe udhëzimeve tjerat të institucioneve përgjegjëse vendore.
- Të mbahet distanca sociale.

II. Përgatitja e vendit të punës për mbrojtje nga COVID 19

Të gjithë të punësuarit duhet të shqyrtojnë mundësitë e tyre më të mira për të zvogëluar përhapjen e COVID-19 dhe për të ulur ndikimin e tij në vendin e tyre të punës.

1. Ruajtja e mjedisit të shëndetshëm të punës

Që të ruhet mjedisi dhe të krijohet një ambient i shëndetshëm në hapësirat e punës duhet të zbatohen masat si në vijim :

- Sigurimi dhe rritja e sistemit të ventilimit në objektet ku sistemi i tillë ekziston.
- Rritja e nivelit të ajrit të jashtëm në hapësirat e brendshme të objektit.
- Në të gjitha hapësira të mundshme duhet të ketë shporta mbeturinash.
- Materiali higjienik duhet të jetë prezent në të gjitha hapësirat përkatëse.
- Në të gjitha korridoret duhet të ketë dezinfektues për duar me përmbajtje më se paku 70% alkool. Aty ku ka ujë të ngrohtë dhe sapun preferohet të përdoret më shumë, se sa dezinfektuesi.
- Në hyrje të objektit duhet të vendosen shenja sinjalizuese për të punësuarit dhe palët që frekuentojnë objektin. Në çdo kat duhet të vendosen broshura informuese që promovojnë larjen e duarve.
- Zyrat duhet të pastrohen rregullisht dhe të dezinfektohen. Pastrimi dhe dezinfektimi bëhet në mënyrë rutine, të gjitha sipërfaqet që preken shpesh, siç janë tavolinat e punës, tastierat, telefonat, mjete tjera të punës dhe dorezat e dymuara.
- Sallat e takimeve, para dhe pas çdo takimi, duhet të pastrohen dhe të dezinfektohen.
- Duhet të evitohet shtrëngimi i duarve në rast të përshëndetjeve.
- Nuk preferohet të përdoret lifti, shfrytëzimi i shkallëve është më se i domosdoshëm. Lifti nuk mund të shfrytëzohet nga me shumë se një person në lift.

- Duhet të respektohen masat në rast të kollitjes apo teshtitjes, si dhe pastrimi i duarve duhet të jete më i shpeshtë.

2. Kujdesi ndaj njëri tjetrit

Duke marr parasysh që bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve me njëri tjetrin, është tepër i nevojshëm, kujdesi ndaj njeri tjetrit është obligativ, andaj duhet që të:

- Shmangni përdorimin e telefonave, tavolinave, zyrave apo mjeteve, pajisjeve dhe aparaturave tjera të punës të kolegëve tjerë kur është e mundur. Nëse përdorimi i tyre është i pashmangshëm, atëherë pastroni dhe dezinfektoni para se t'i përdorni.
- Sigurohen lecka/faculeta për një përdorim ashtu që sipërfaqet e përdorura më së shpeshti (p.sh., dorezat e dyerve, tastierat, pilotët e TV aparateve, klimave, tavolinat dhe mjetet e pajisjet tjera të punës) mund të pastrohen nga të punësuarit para secilit përdorim.
- Shmangeni hyrjet dhe daljet në zyrat tjera, përveç në rastet kur është e domosdoshme.
- Përdorni komunikatorin, telefonin dhe mundësi tjera të komunikimit në mënyrë që t'i shmangni kontaktet.
- Shmangni grumbullimet në korridore të objekteve.

3. Distancimi Fizik

Zbatim i distancimit fizik është njëra nga masat obligative për secilin punonjës. Distancimi fizik do të thotë t'i shmangni takimet dhe grumbullimet me numër të madh të pjesëmarrësve dhe ruajtjen e distancës (së paku 1.5 metra – 2 metra) nga të tjerët, kurdo që është e mundur (p.sh., në takime, në zyra, në korridore etj). Për të krijuar distancën fizike duhet:

- Ruajtja e distancës fizike ndërmjet personelit në vendin e punës;
- Ruajtja e distancës fizike mes personelit dhe palëve;
- Realizimi i takimeve përmes videokonferencave si dhe platforma tjera si zoom, skype etj.
- Ofrimin e shërbimeve në distancë (p.sh. telefon, video apo ueb-aplikacione);
- Dorëzimin e lëndëve përmes postës apo shërbimeve postare.
- Dorëzimin e shkresave përmes postës elektronike.

4. Menaxhimi i hyrjeve dhe daljeve përmes recepcionit dhe zyrtarëve të sigurisë

Zyrtari përgjegjës në recepcion duhet të mbikëqyrë dhe koordinoj, hyrjet dhe daljet në objekt, sipas udhëzimit të sigurisë dhe udhëzimeve të paraqitura në këtë dokument.

Zyrtarët e sigurisë duhet të kontrollojnë dhe të sigurojnë zbatimin e rregullave për hyrje dhe dalje në objekt, sipas udhëzimit të sigurisë dhe masave të përcaktuara me këtë udhëzim.

5. Organizimi i punës në zyre

Stafi duhet të kthehet në punë në mënyrë graduale duke u bazuar në vendimet e Qeverisë, vendimet e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Planit të Veprimit për Menaxhimin e Krizave si dhe planit të përgatitur nga mbikëqyrësit.

Praktikantëve në sistemin prokurorial ju pezullohet vijimi i praktikës, derisa të krijohen kushtet dhe rrethanat për vijimin e praktikës.

Gjatë realizimit të punëve në zyrë duhet të respektohen masat e përcaktuara me këto udhëzime.

Zyrat duhet të jenë të organizuara, në mënyrë që të ruhet distanca mes njeri tjetrit. Nëse kjo është e pamundur për shkak të numrit të madh të zyrtarëve në një zyrë dhe nëse nuk ka mundësi të krijohen hapësira tjera brenda objektit, atëherë puna duhet të organizohet me rotacion sipas planit të përgatitur nga mbikëqyrësi.

6. Komunikimi

Komunikimi i brendshëm duhet të bëhet përmes mjeteve të komunikimit zyrtar si email-i, telefoni dhe komunikatori.

Aty ku është e mundur, nga secila njësi, të caktohet zyrtari përgjegjës për shkresa dhe dokumente të brendshme, me qëllim që të reduktohet numri i kontakteve.

Komunikimi i jashtëm përfshirë prokuroritë, institucionet tjera dhe operatorët ekonomik duhet të realizohet në mënyrë elektronike, për aq sa është e mundshme.

Koordinimi i realizimit të të gjitha aktiviteteve duhet të bëhet në koordinim me udhëheqësit e njësive përkatëse dhe administratorët.

Secili zyrtar duhet paraprakisht të koordinohet me mbikëqyrësin, për të gjitha aktivitetet që duhet t'i kryej jashtë objektit të tij.

7. Organizimi i takimeve

Në kohën kur ende ekziston rreziku i infeksionit, për aq sa është e mundur, takimet e organizuara duhet të mbahen në hapësira të përshtatshme për respektim të distancës.

Të gjitha takimet, trajnimet dhe komunikimet, për aq sa është e mundur, duhet të realizohen duke përdorur pajisjet dhe platformat e TI, përmes e-mail, komunikatorit dhe format tjera të komunikimit virtual apo elektronik.

Në rast të paraqitjes së nevojës për ndihmë nga stafi i TI, është e nevojshme që intervenimi të realizohet përmes HelpDesk-ut apo kominikatorit.

8. Shërbimet e byfes

Byfeja brenda objektit mund të punoj dhe të ofroj shërbime sipas kontratës.

Të punësuarit mund të shfrytëzojnë shërbimet e byfesë, vetëm nëse pijet dhe ushqimi porositën dhe merren me vete.

Të punësuarit nuk mund të qëndrojnë në byfe dhe po ashtu, nuk mund të shoqërojnë kolegët për kafe.

Stafi i byfesë duhet të zbatoj masat sipas këtij udhëzimi, duke përdorë materialet mbrojtëse, pastrimin dhe dezinfektimin e byfesë dhe pajisjeve tjera të punës.

9. Shërbimet e transportit

Shërbimet e transportit ofrohen kryesisht nga shoferet. Shoferët duhet të kujdesen për të gjitha veturat zyrtare në bashkëpunim me përgjegjësit e tyre. Që zyrtaret e transportit të sigurojnë dhe të kujdesen për të punësuarit sipas qëllimit të këtij udhëzuesi duhet qe:

- Në vetura duhet të ketë dezinfektues.
- Nuk duhet të ketë me shumë se dy zyrtarë në veturë përfshirë zyrtarin e transportit
- Vetura duhet të dezinfektohet para dhe pas çdo shfrytëzimi.
- Vetura duhet të pastrohet rregullisht.
- Veturat duhet të pastrohen me mjete pune për pastrim (lecka, letër pastrim), pa prekur direkt me duar këto sipërfaqe. Përdorni doreza gjatë pastrimit. Këto lecka-letra hedhen në thasë për mbeturina.

III. Qasje në objektet e sistemit prokurorial

1. Hyrja në objekt

Hyrja e objektit duhet të jetë e pajisur me dezinfektues çdo person (i punësuar dhe palë) i cili hynë në objekt duhet të jetë i pajisur me dorëza dhe maska.

Në rast të mos përdorimit të këtyre pajisjeve, recepcioni dhe sigurimi duhet të udhëzojnë këta persona që të pajisjen me maska dhe dorëza, në të kundërtën nuk mund të vazhdojnë tutje.

Pritjet, duhet të organizohen nga zyrtarët e sigurisë, duke krijuar distancën dhe duke shfrytëzuar hapësirën e jashtme, nëse është e nevojshme.

Sipas radhës, me një distancë prej 1.5-2 metra, personat duhet të kryejnë apo të marrin shërbimet për të cilat kanë nevojë. Nuk lejohet më shumë se dy persona të presin në hapësirat e brendshme.

Secili person, përfshirë dhe të punësuarit e sistemit prokurorial, që hyn në objekt, është e nevojshme të bëjnë dezinfektimin e duarve/dorëzave, me dezinfektuesit e vendosur në hapësira të brendshme të objektit.

2. Pranimi i lëndëve, shkresave dhe dokumenteve tjera të ndryshme

Të gjitha lëndët që adresohen për shkrimoret e prokurorive duhet të pranohen nga zyrtari përgjegjës i shkrimores duke u siguruar respektimin e distancës dhe udhëzimeve tjera të përcaktuar me këtë dokument.

Të gjitha shkresat dhe dokumentet tjera të ndryshme nga prokuroritë, institucionet tjera, operatorët dhe palët duhet të vendosen në sirtarët të cilët janë në hyrje të objektit, përkatësisht, tek recepcioni. Secili sirtar, duhet ta ketë mbishkrimin e njërive përgjegjëse.

Recepcioni, duhet të udhëzoj çdo person për mënyrën e vendosjes së lëndës në sirtar.

Zyra e Arkivës, është e obliguar të marr të gjitha lëndët t'i regjistroj, si dhe të njoftoj dorëzuesin me e-mail për pranimin e lëndës, duke ja bashkëngjitur edhe kopjen e dokumentit të protokolluar.

Zyrtarët përgjegjës, duhet të koordinohen me recepcionistin, për marrjen e dokumenteve për shkak të afateve të caktuara.

3. Hyrjet dhe daljet brenda dhe jashtë objektit

Duke marr parasysh se disa nga vizitat zyrtare është e pamundur të shmangen, atëherë në mënyrë rigoroze duhet të respektohen këto masa:

- Respektimi i distancës.
- Mbajtja e maskave dhe dorezave.
- Marrja dhe përcjellja e vizitorëve nga zyrtarët përgjegjës.
- Mbajtja e higjienës sipas këtij udhëzuesi.

Në rast të vizitave të jashtme, duhet të merren masa parapake:

- Në vetura nuk duhet të jetë, më shumë se dy zyrtarë përfshi edhe shoferin.
- Të siguroheni që veturat janë pastruar dhe dezinfektuar paraprakisht.
- Të siguroheni se masa të ngjashme me këtë udhëzues zbatohen edhe nga pala pritëse.

Vizitat në objekt nga persona privat nuk lejohen.

4. Marrja në pyetje e palëve

Organizimi i seancave dhe marrja në pyetje e palëve, duhet të bëhet në mënyrë të koordinuar paraprakisht me përgjegjësit e prokurorive.

Të gjitha masat e përcaktuara me këtë udhëzues, përshtatshëmrisht duhet të zbatohen edhe me rastin e marrjes në pyetje të palëve.

Secila prokurori duhet të caktoj hapësirat, përkatësisht sallat për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Përcjellja e palëve, duhet të bëhet nga zyrtarët përgjegjës. Në asnjë mënyrë, nuk duhet të lejohet lëvizja e palëve, pa mbikëqyrje.

Në salla duhet të vendosen dezinfektues, maska dhe doreza.

Të gjitha kontrollet e palëve kryhen sipas udhëzimit për siguri.

IV. Mirëmbajtja higjienike në objektet sistemit prokurorial

Pastrimi dhe dezinfektimi duhet të bëhet tri herë në ditë (në mëngjes, drekë dhe pasdite) për:

- Sipërfaqet (tavolinat, karriget dhe gjësendet tjera) dhe ambientit të punës,
- Sallat në objekte.
- Byfeja.
- Lifti.
- Hyrja e objektit me të gjitha pajisjet.

Dezinfektimi duhet të bëhet duke pastruar me mjete pune për pastrim (lecka, letër pastrim) pa prekur direkt me duar këto sipërfaqe. Gjatë pastrimit duhet të përdoren dorëzat, si dhe leckat-letra të hedhen në thasë për mbeturina.

Korridoret duhet të pastrohen rregullisht nga stafi përgjegjës për mirëmbajtje higjienike, si dhe duhet të bëhet dezinfektimi i të gjitha pajisjeve të TI, të cilat janë të vendosura në korridore.

Stafi që kryejnë pastrimin dhe dezinfektimin, duhet të kenë njohuri me procedurat dhe preparatet dhe në raste të dyshimta pastrimi duhet të bëhet, duke përdorur pajisjet e duhura mbrojtëse personale.

Pajisjet personale për pastrim duhen të trajtohen si një material potencial infektues dhe të hidhen apo asgjësohen në vende të sigurta për material infektiv.

Nëse dyshemetë, sipërfaqet dhe materialet nga tekstili (tepih, perde ose të ngjashme), nuk mund të përballojnë preparatet e klorit, konsultoni instruksionet e prodhuesit për zgjedhjen e ndonjë alternative të përshtatshme, e shoqëruar ose e kombinuar me pastrim me detergjent.

Të gjitha zonat që preken shpesh, siç janë, dorezat e dyerve, muret dhe dritaret, guaca dhe sipërfaqet tjera të tualetit, duhet gjithashtu të pastrohen me kujdes. Të gjitha tekstilet (p.sh. karriget, perdet, etj.) duhet të lahen duke përdorur, një cikël me ujë të nxehtë (90 ° C) dhe duke shtuar detergjent për larje. Nëse një cikël me ujë të nxehtë, nuk mund të përdoret për shkak të karakteristikave të tekstilit,

kimikate specifike duhet të shtohen kur lani tekstilet (p.sh. produkt zbardhues ose detergjent që përmbajnë hipoklorit të natriumit ose produkte dekontaminimi të prodhuara, posaçërisht për t'u përdorur në tekstile).

Kur përdoren produkte kimike për pastrim, është e rëndësishme të mbahet vendi i ajrosur mirë (p.sh. duke hapur dritaret), në mënyrë që të mbrohet shëndeti i personelit të pastrimit.

Masat Parandaluese

Ruajeni shëndetin tuaj dhe mbroni të tjerët duke bërë kështu:

Lani duart tuaja sa më shpesh



Pastroni rregullisht dhe tërësisht duart tuaja me një larës të bazuar në alkool ose lani ato me sapun dhe ujë.

Pse?

Larja e duarve me sapun dhe ujë, apo me bazë në alkool i vret viruset të cilat mund të jenë në duart e juaja.


Shmangni prekjen e Syve, Hundës dhe Gojës



Pse?

Duart prekin shumë vende dhe mund të kapin viruse. Kur infektohen, duart mund të transferojnë virusin tek sytë, hunda apo goja juaj. Prej aty, virusi hyn në trupin tuaj dhe mund të sëmureni.

Mbani Distancë nga të tjeret



Mbani së paku 1 metër distancë ndërmjet jush dhe personat që kolliten apo teshtijnë.

Pse?

Kur dikush kollitet ose teshtin, ata nxjerrin spërkla në formë pikave të vogla të lëngshme nga hunda ose goja e tyre që mund të përmbajnë virusin. Nëse jeni shumë afër, ju mund ta merrni përmes spërklave virusin COVID-19 nëse personi që kollitet e ka sëmundjen.

Nëse keni Ethe, Kollë, dhe Vështirësi në Frymëmarrje, kërkoni kujdes mjekësor sa më shpejtë



Qëndroni në shtëpi nëse nuk ndiheni mirë. Nëse keni ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje, kërkoni kujdes mjekësor dhe telefononi paraprakisht. Ndiqni udhëzimet e autoritetit tuaj lokal shëndetësor.

Pse?

Autoritetet qendrore dhe lokale do të kenë informacionin më të fundit mbi situatën në zonën tuaj. Thirrja paraprakisht do të lejojë ata t'ju drejtojnë sa më shpejt në institucionin e duhur shëndetësor. Kjo gjithashtu do t'ju mbrojtë juve dhe do të ndihmojë në parandalimin e përhapjes së viruseve dhe infeksioneve të tjera.